



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 259/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković– Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE NTP “Vlora”- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik: “Europrinty” shpk –Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr.prok: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinë , më datën 20.06.2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik OE NTP “Vlora”- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr.prok: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinë .

II. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr.prok: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinë, dhe lënda kthehet ne Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues NTP “Vlora”- Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Data e njoftimit për kontratë është bërë me dt: 05.03.2019

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është bërë me dt:02.04.2019

Data e hapjes së ofertave është bërë me dt: 02.04.2019.

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave është bërë me dt:14.05.2019.

Data e njoftimit me letrën standarde për tenderuesit te pa suksesshëm është bërë me dt:15.05.2019.

Data e kërkesës për rishqyrtim është bërë me dt: 22.05.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim është bërë me dt: 24.05.2019.

Operatori ekonomik ankues NTP “Vlora”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29.05.2019, me nr. 259/19, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me Rekuizita Sportive” me nr.prok: 616-19-860-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinë, duke pretenduar se :

- Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje te nenit 1, 7, 59, 60, 66.1, 69, dhe 72, te Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës si dhe nenin 26.8 i UOPP tabela pika k , 29.8 UOPP pika 1 , 39 dhe 41 të UOPP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 03.06.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti Shqyrtues në raportin e dt:13.06.2019, sqaron se Autoriteti Kontraktues, Komuna Prishtinë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim (kornizë –

12 muaj) me vlerë të mesme. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër ofertës së operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës, “Europrinty” shpk, si edhe OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i përgjegjshëm por i pa suksesshëm.

Kundër të njëjtit propozim parashtruesi i ankesës më datën 22.05.2019, ka paraqitur kërkesë për ri shqyrtim me pretendimet e njëjta ankimore të paraqitura si në ankesën e deponuar në OSHP. AK – Komuna Prishtinë, më datën 24.05.2019, nxjerr vendim dhe refuzon të njëjtën kërkesë si të pa bazuar.

Pretendimet kryesore ankimore kundrejt të dy OE–ve, të lartë përshkruar ndërlidhen me kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku AK, (pas përmirësimit të gabimit) në piken 9.1, të FDT-së, ka kërkuar: “OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme (gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€”. Për të njëjtën kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: “Një liste të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të DT, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve”.

Pra, AK Komuna Prishtinë, përmes kërkesës ka potencuar se ofertuesit duhet të prezantojnë dëshmi për projekte të përfunduara gjatë tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (05.03.2019).

Përderisa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, në Aneksin 6 të DT, ka përshkruar gjithsej 4, projekte, me vlerë të përgjithshme prej 101 650.20 €.

AK përmes procesit të vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga i njëjti OE, dhe përmes përgjigjes i njëjti ka prezantuar kopje të faturave, ku përmes të cilave mbulohet vlera e kërkuar në dosje të tenderit, megjithatë kundrejt faturave të njëjta nuk janë prezantuar të gjitha kopjet e referencave. Konkretisht OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar, referencën e datës 05.01.2019, të lëshuar nga “Office Trade”, në vlerë prej 32,324.35 €, dhe referencën e datës 20.01.2018, të lëshuar nga “Mediatech” në vlerë prej 45 623.85 €, rrjedhimisht faturat e prezantuara kundrejt këtyre dy projekteve të përshkruara si të realizuara, nuk e mbulojnë vlerën e kërkesës së AK-së, ndërsa referencat tjera, ajo e Komunës së Obiliqit dhe Kforit, nuk janë prezantuar.

Në vijim po sqarojmë pretendimet ankimore kundrejt ofertës së OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i suksesshëm.

Sipas shkresave të lëndës së OE NTG "Blendi, rezulton që i njëjti përmes ofertës ka prezantuar listën e projekteve me gjithsej 5 projekte të realizuara, megjithatë si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencën e datës 11.05.2017, të lëshuar nga SHKK- Ministria e Drejtësisë, në vlerë prej 1,265.50 €, si dhe disa kopje të faturave, ku përmes të cilave nuk vërtetohet se i njëjti e mbulon kërkesën e AK-së.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Neni 59, LPP – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa nëse përgjatë seancës dëgjimore eventuale, përfaqësuesit e AK-së, nuk prezantojnë provat: Referenca e Komunës së Obiliqit dhe Kforit, atëherë lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Operatori ekonomik OE NTP "Vlora"- Prishtinë, përmes parashtresës me shkrim të datës: 14.06.2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet pjesërisht me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, eksperti shqyrtues i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-së z. Krasniqi deklaroj: Qëndrojmë ne tërësi prapa ankesës nr 259/19 me date 13.06.2019. Siç e kemi cekur ne e-mailin e dt.14.06.19, pajtohemi me mendimin e ekspertit shqyrtues që lënda të kthehet në ri-vlerësim.

Kërkojmë nga paneli të shqyrtoj pretendimin ankimor për certifikatat dhe a testet e dorëzuara nga OE I rekomanduar për kontrate nga AK pasi që eksperti nuk ka dhënë mendim lidhur me këtë pretendim ankimor.

OE i rekomanduar për kontrate nga AK në një tender ku kemi të bëjë me furnizim të inventarit dhe rekuizitave sportive si dëshmi dokumentare se pajisjet e ofruara janë në harmoni me standardet e kërkuara në përshkrimin e artikujve për këtë tender ka dorëzuar certifikate ISO dhe a –teste për lodra, sqarim me të detajuara në ankese. OE I rekomanduar për kontrate nga AK është i papërgjegjshëm dhe nuk plotëson kërkesën lidhur me kapacitetin teknik dhe/ose profesional të paraqitur në nenin 9.1 të FDT-së, dhe me pas

te përmirësuar nga AK me ane te formularit për ndryshime ne dosjen e tenderit ku AK kërkon te dorëzohen dëshmi se OE ka përfunduar me sukses kontrata te ngjashme, si dëshmi kërkohen referencat apo certifikatat për kryerjen e furnizimeve.

OE i rekomanduar për kontrate nga AK nuk plotëson këtë kërkesë pasi qe nga 4 projektet e prezantuara ne listën e kontratave ne ANKES 6 nuk ka dorëzuar dëshmi mbi realizimin/përfundimin e kontratave ne minimumin e kërkuar ne FDT prej 50,000.00 euro. Siç ka cekur dhe eksperti shqyrtues faturat/dëshmitë e furnizimeve për “Mediatech” dhe “Office trade” nuk mbulojnë vlerën e kontratave te paraqitur ne liste dhe si te tilla nuk mund te pranohen si kontrata te përfunduara ndërsa furnizimet për KFOR nuk kane ngjashmëri me këtë aktivitet te prokurimit, furnizimi me kamina, bidon me ujë, banka, karrika, dërrase te zezë, tabela etj nuk kane te beje me rekuizita sportive. kontrata tjetër e paraqitur ne liste me KK Obiliq nuk ka te bashkangjitur referencën apo certifikatën si dëshmi për kryerjen e furnizimeve si dhe faturat e bashkangjitura kësaj kontrate janë jashtë periudhës se kontratës 22.06.2017.-22.06.2018. bazuar ne këtë kemi dyshime se OE I rekomanduar për kontrate nga AK ka paraqitur dëshmi jo valide, fatura fiktive prandaj dhe kemi kërkuar nga AK qe te beje verifikimin e tyre ne pajtim me shkresën e AK ne ANEKS 6 te dosjes se tenderit.

Po ashtu OE i dyte i klasifikuar si i përgjegjshëm nga AK është i papërgjegjshëm pasi qe kontratat e paraqitura ne liste ne ANEKS 6 te dosjes se tenderit nuk plotësojnë kërkesën e AK lidhur me dorëzimin e dëshmimeve për furnizime te ngjashme, kontratat me KK-Gracanice dhe Universitetin e Prishtinës janë ne proces dhe si te tilla nuk mund te pranohen si dëshmi pasi qe nuk janë kontrata te përfunduara.

Gjatë prezantimit ne seancë përfaqësuesja e AK-së znj. Bajrami deklaroj: Sa i përket OE te dyte, “Blendi” e ka proces verbalin ne fund te furnizimeve me UP e është ne vlere 61.045 euro për furnizim me rekuizita sportive ku vetëm ne këtë kontrate ai mbush kushtet ne pjesëmarrëse si i përgjegjshme, ndërsa sa i përket OE te shpallur fitues Europrinty, ka ofruar dëshmi te mjaftueshme për këtë AP ne bazë dyshimeve qe ka bere komisioni i vlerësimit ka kërkuar sqarim shtesë lidhur me disa kontrata te prezantuar OE ne fjale u është përgjigjur sqarimeve duke kthyer faktuar atë cilat përmbushin vlerën 50.000 te furnizimeve te ngjashme, duke marr parasysh ne ato fatura mbahet një komision si proces verbal i furnizimeve atëherë komisioni i vlerësimit ka vendos qe te propozon për dhënie te kontratës OE me te lirë te përgjegjshëm.

Gjatë prezantimit ne seancë eksperti shqyrtues z. Bibaj deklaroj: Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër 2 ofertave te kualifikuara te përgjegjshme me çmim me te lire përkatësisht lidhur me kapacitete teknik dhe profesional ku pretendohet se te njëjtin nuk kanë ofruar dëshmi se nuk kanë realizuar projekte

te ngjashme. Autoriteti Kontraktues përmes vlerësimit të ofertave ka kërkuar nga OE i rekomanduar i njëjti të prezantuar fatura dhe të njëjtat janë pranuar si të arsyeshme. OE i rekomanduar për dhënie tek lista e kontratave tek ANEKSI 6 ka prezantuar gjithsej 4 Projekte mirëpo si dëshmi ose referenca në oferte i ka prezantuar 2 prej tyre. Sipas faturave të pranuar OE i rekomanduara e mbulon vlerën e kontratës megjithatë arsyeja pse kam propozuar nëse 2 prej tyre nuk prezantohen në seance lënda mu ktheje në rivlerësim ka e bëje se Autoriteti Kontraktues si dëshmi ka kërkuar referenca ose Certifikata për kryerjen e furnizimeve dhe atë në 3 vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë. Do të thotë referenca e prezantuar nga Mediatech – print dhe Office Trade si vlerë të referencës e mbulon kërkesën mirëpo faturat e prezantuara nuk e mbulojnë vlerën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktues e njëjta është edhe për OE të ranguar nga çmimi ku në bazë të dëshmive dhe shkresave i njëjti nuk ka vërtetuar që mbulon vlerën e njëjte sipas dëshmive që ka kërkuar Autoriteti Kontraktues.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së ankuese z. Krasniqi deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovojë ankesën e kompanisë sonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në ri-vlerësim. Gjithashtu kërkojmë edhe nga AK- KK Prishtinë që ri-vlerësimin e ofertave ta bëjë në pajtim me kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesja e AK-së znj. Bajrami deklaroj: Propozojmë që të refuzohet ankesa e OE.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se OE ankues NTP “Vlora” Prishtinë, pretendon se operatorit ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës, “Europrinty” shpk, si dhe OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i përgjegjshëm por i pa suksesshëm nuk i kanë plotësuar kërkesat e autoritetit kontraktues, ashtu siç është kërkuar në FDT.

Sa i përket pretendimit të OE ankues kundrejt të dy OE-ve, të lartpërmendur që ndërlidhen me kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku autoriteti kontraktues (pas përmirësimit të gabimit) në piken 9.1, të FDT-së, ka kërkuar si në vijim : *“OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontratë për furnizime të ngjashme (gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) jo më pak se 50,000.00€”*. Për të njëjtën kërkesë si dëshmi dokumentare është kërkuar: *“Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të DT, ku duhet saktësuar titullin e kontratës,*

datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjitën referencat ose certifikatat për kryerjen e furnizimeve”.

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se AK Komuna Prishtinë, përmes kërkesës ka potencuar se ofertuesit duhet të prezantojnë dëshmi për projekte të përfunduara gjatë tri vitet e fundit duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë (05.03.2019). Ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës “Europrinty” shpk, në Aneksin 6 të DT, ka përshkruar gjithsej katër (4), projekte, me vlerë të përgjithshme prej 101 650.20 €.

AK Komuna Prishtinë, përmes procesit të vlerësimit të ofertave ka kërkuar sqarime shtesë nga OE në fjalë, dhe përmes përgjigjes i njëjti ka prezantuar kopje të faturave, ku përmes të cilave mbulohet vlera e kërkuar në dosje të tenderit, megjithatë kundrejt faturave të njëjta nuk janë prezantuar të gjitha kopjet e referencave. Konkretisht OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar, referencën e datës 05.01.2019, të lëshuar nga “Office Trade”, në vlerë prej 32,324.35 €, dhe referencën e datës 20.01.2018, të lëshuar nga “Mediatech” në vlerë prej 45 623.85 €, ku rrjedhimisht faturat e prezantuara kundrejt këtyre dy projekteve të përshkruara si të realizuara, nuk e mbulojnë vlerën e kërkesës së AK-së, ndërsa referencat tjera, ajo e Komunës së Obiliqit dhe Kforit, nuk janë prezantuar.

Sa i përket pretendimi të OE ankues NTP “Vlora” –Prishtinë, kundrejt ofertës së OE NTG “Blendi”, i kualifikuar si i suksesshëm. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se OE NTG “Blendi”, ka prezantuar listën e projekteve me gjithsej pesë (5) projekte të realizuara, megjithatë si dëshmi dokumentare ka prezantuar referencën e datës 11.05.2017, të lëshuar nga SHKK- Ministria e Drejtësisë, në vlerë prej 1,265.50 €, si dhe disa kopje të faturave, ku përmes të cilave nuk vërtetohet se i njëjti e mbulon kërkesën e AK-së.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës si dhe në ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit si dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së, dhe njëkohësisht obligon autoritetin kontraktues Komuna e Prishtinë, që gjatë rivlerësimit konform nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, ti verifikoje dhe të kërkojë sqarime shtesë për të gjitha dëshmitë-dokumentet dhe referencat (e OE-së, të rekomanduar për kontratë), të cilat i konteston operatori ekonomik ankues, ashtu siç u cek më lartë, më saktësisht të vërtetojë se OE i rekomanduar për kontratë a ka plotësuar kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale, në piken 9.1, të FDT-së.

kopjet e referencave. Konkretisht OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar, referencën e datës 05.01.2019, të lëshuar nga “Office Trade”, në vlerë prej 32,324.35 €, dhe referencën e datës 20.01.2018, të lëshuar nga “Mediatech” në vlerë prej 45 623.85 €, ku rrjedhimisht faturat e prezantuara kundrejt këtyre dy projekteve të përshkruara si të realizuara, nuk e mbulojnë vlerën e kërkesës së AK-së, ndërsa referencat tjera, ajo e Komunës së Obiliqit dhe Kforit, nuk janë prezantuar.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Prishtinë

1x1 OE – NTP “Vlora” Prishtinë,

1x1Për publikim në web- faqe të OSHP-së.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

